



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
OSNOVNI SUD U PRIZRENU - BASIC COURT OF PRIZREN

---

**AD-GJTHPZ.nr.7/24**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, Kryetarja e gjykatës Shpresa Emra, duke vepruar sipas kërkesës për inicim të procedurës disiplinore të parashtruar nga ana e ankueses A.P.; nga Prizreni, respektivisht të përfaqësuesit të saj av.A.M., nga Prizreni, ndaj gjyqtarit S.G., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës përmbare CP.nr.167/24, në bazë të së cilës është bërë inicimi i procedurës disiplinore, me dt.24.07.2024, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

**REFUZOHET si e pabazuar** ankesa e ankueses A.P., nga Prizreni, respektivisht të përfaqësuesit të saj av.A.M., nga Prizreni ndaj gjyqtarit S.G., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës përmbare CP.nr. 167/24.

### **A r s y e t i m**

Parashtruesi i ankesës A.P., nga Prizreni, respektivisht përfaqësuesja e saj av.A.M., nga Prizreni me datë 20.06.2024 pranë Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka parashtruar kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit S.G., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës përmbare CP.nr. 167/24. Kjo kërkesë përmes KGJK-së me datë 26.06.2024 është përcjellë në Gjykatën Themelore në Prizren.

Ankuesi av.A.M., nga Prizreni, në kërkesën e paraqitur ka deklaruar se pala A.P., të cilën e përfaqëson në lëndën CP.nr. 167/24, me datë 23.04.2024 ka pranuar propozimin për përmbare të parashtruar nga ana e kreditorit A.S., të cilin e përfaqëson av.R.B.,. Këtë propozim dhe aktvendimin për lejimin e përmbaremit, e njëjta ka pranuar në gjuhën shqipe, gjuhë të cilën ajo nuk e kupton dhe nuk e flet, pasi që ajo është e nacionalitetit boshnjak. Duke qenë se propozimi për përmbare nuk kishte numër të caktuar të lëndës apo numër të protokollit, si avokat i autorizuar ka kontrolluar regjistrimin e lëndës së caktuar në gjykatë, mirëpo lënda CP.nr.167/24 nuk ishte e regjistruar në SMIL. Pas kësaj me datë 24.04.2024 është drejtuar gjykatës dhe pas ankesave për shkak të mos regjistrimit të lëndës në SMIL, Gjykata Themelore

në Prizren në mënyrë retroaktive e regjistron lëndën. Me datë 10.05.2024 është caktuar seanca në këtë çështje dhe si përfaqësues i autorizuar i palës debitore ka kërkuar nga gjyqtari i çështjes njoftim me shkrim se si mund të caktohet seanca gjyqësore dhe të gjykohet një çështje që nuk është e regjistruar fare në SMIL. Nga e gjithë kjo, Gjykata Themelore në Prizren, i shpërfill ankesat dhe kundërshtimet e përfaqësuesit të autorizuar të debitorës A.P., dhe pa asnjë provë merrë vendim në favor të kreditorit të përmbarrimit. Me këtë deklaron se në këtë rast kemni të bëjmë me manipulim të provave dhe jo paraqitjen e drejtë të gjendjes faktike, por marrjen e vendimeve të shpejta pa e regjistruar lëndën, me qëllim që largohet një fëmijë i mitur nga nëna e tij. Andaj, ka kërkuar që të fillohet procedura disiplinore kundër gjyqtarit S.G., lidhur me këtë lëndë.

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar ankesën ndaj gjyqtarit S.G., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, lidhur me lëndën CP.nr.167/24 ka iniciuar hetimet preliminare për procedurë disiplinore dhe ka ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim. Fillimisht ka bërë shikimin në ankesën e parashtruar, ka kërkuar deklaratë nga gjyqtari i çështjes si dhe ka bërë shikimin e shkresave të lëndës CP.nr. 167/24.

Gjyqtari në deklaratën e tij të datës 28.06.2024 lidhur e pretendimet e ankuesit ka cekur se lënda me numër CP.nr.167/2024 dhe me numër të lëndës me SMIL 2024: 103972, tek zyra e gjyqtarit është pranuar me datën 04.04.2024 dhe gjyqtari propozimin për përmbarrim e ka lejuar me aktvendimin CP.nr.167/2024 të datës 04.04.2024. Pala debitore A.P., nga Prizreni, propozimin për përmbarrim në Gjuhën Shqipe, të lejuar me aktvendimin CP.nr.167/2024 të datës 04.04.2024, e cila vulë është në dy gjuhë zyrtare, e ka pranuar me datën 23.04.2024 personalisht me emër dhe mbiemër ku shihet në fletë dërgese për dorëzim personal të kësaj gjykate. Ndaj aktvendimit për lejimin e përmbarrimit pala debitore nuk ka paraqitur prapësim, por e autorizuar e saj av.A.M., e ka bërë një parashtrësë në formë të njoftimit urgjent me datën 25.04.2024. Me datën 10.05.2024 në këtë çështje përmbarrimore është mbajtur seanca dëgjimore, për shkak të kontaktit me fëmijë, dhe kjo seancë është mbajtur përmes përkthyesit gjyqësore të kësaj gjykate. Gjykata propozimin për përmbarrim të përkthyer në gjuhën që e kupton pala, ja ka dorëzuar të autorizuarës av. A.M., nga Prizreni, ku e njëjta e ka pranuar me datën 13.05.2024, dhe e njëjta që nga paraqitja e propozimit për përmbarrim, nuk ka pasur autorizim për ta përfaqësuar debitorën A.P., ndërsa tek me datën 25.04.2024 përmes parashtrësës e ka dorëzuar edhe autorizimin për përfaqësim. Gjykata lidhur me parashtrësën e të autorizuarës së debitorës av. A.M., e paraqitur në formë të njoftimit urgjent të datës 25.04.2024, e ka konsideruar si prapësim kundër aktvendimit për lejimin e përmbarrimit. Gjykata me aktvendimin CP.nr. 167/2024 të datës 29.05.2024, ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorës A.P., nga Prizreni, i paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren CP.nr. 167/2024 të datës 04.04.2024, dhe mbetet në fuqi i njëjti aktvendim për përmbarrim. Ndaj këtij aktvendimi CP.nr.167/2024 të datës 29.05.2024, e autorizuar e debitorës, A.M., nga Prizreni ka paraqitur ankesë me datën 14.06.2024. Lidhur me pretendimet e të autorizuarës së debitorës, av.A.M., respektivisht palës ankuese se, gjyqtari i çështjes ka bërë shkelje të detyrave të punës gjatë trajtimit të çështjes përmbarrimore CP.nr. 167/2024, duke ja dërguar propozimin për përmbarrim në gjuhën shqipe palës debitore A.P., pasi që ë njëjta është e nacionalitet boshnjak, ka theksua se janë të pa baza këto pretendime dhe të pa justifikueshme, pasi që gjyqtari fillimisht as nuk ka pasur dijeni se e njëjta i takon nacionalitetit boshnjak, ngase të gjitha shkresat e lëndës të dorëzuar nga i autorizuari i kreditorit, janë dorëzuar në gjuhën shqipe dhe gjyqtari i çështjes nuk ka mundur ta di se debitorja A.P., është e nacionalitet boshnjak, po të ishte në dijeni të këtij fakti nuk do të ekzistonte në asnjë mënyrë asnjë lloj diskriminimi, pasi që si gjyqtari i çështjes në mënyrë të barabartë i ka trajtuar dhe i trajton të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilët janë palë në procedurë. Ndërkaq sa i përket pretendimit tjetër se gjykata në këtë çështje ka marrë

aktvendim pa e regjistruar lëndën në sistem, këto pretendime janë të pa bazuara, ngase e njëjta lëndë është në sistem, e ka vulën e pranimit me datën 04.04.2024 në këtë gjykatë, dhe është e regjistruar me sistemin SMIL me nr.2024: 103972, ku në shkresat e lëndës është akti i regjistrimit në sistemin SMIL dhe e gjithë procedura është zhvilluar përmes këtij sistemi dhe seanca dhe vendimi janë të regjistruara po ashtu në sistemin SMIL, edhe po të mos ishte lënda e regjistruar në sistemin SMIL, gjykatën nuk e pengon të veprohet në këto raste, pasi që mundet ndonjëherë qe sistemi të mos funksionoj për shkak të ndonjë rrethane. Po ashtu, personeli i kësaj gjykate pranon lëndët dhe i regjistron në sistemin SMIL, gjyqtari nuk ka kompetencë për këto veprime rreth regjistrimit në sistem të lëndëve. Gjyqtari, ndër të tjera ka theksuar se me përgjegjësi të plotë si gjyqtar gjykues në asnjë lëndë e as në lëndën në fjalë nuk ka bërë Shkelje të detyrave të punës dhe shkelje ligjore. Si çdo lëndë tjetër ashtu edhe këtë e ka trajtuar me seriozitetin më të madh të mundshëm, pasi që natyra e çështjes është e ngutshme, ku kemi të bëjmë më kontakte me fëmijë të mitur dhe në këtë procedurë edhe ligji i Procedurës Përmbartimore e parasheh një gjë të tillë që të veprohet me urgjence dhe me ngutshmëri dhe se debitorja e ka pas detyrim dhe ka qenë në dijeni sipas aktgjykimit C.nr.902/2021 të datës 02.06.2022, që të ja mundësoj të paditurit këtu kreditorit A.S., kontaktin me fëmijën e tij të mitur, deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore apo deri sa ky vendim të mos ndryshohet, por e njëjta pra këtu debitorja pasi që ka qenë e njoftuar me këtë aktgjykim, tani për të zvarritur këtë çështje përmbartimore, përmes avokates e prolongon çështjen, duke pretenduar se gjyqtari ka bërë Shkelje të detyrave të punës dhe Shkelje ligjore. Ky pretendim dhe konstatim nga ana e av.A.M., është shumë i pa saktë dhe i pa bazë, pasi që si gjyqtar i çështjes, lëndët në këtë referat i procedon sipas radhës dhe sipas urgjencës së natyrës së lëndës dhe atë sipas dispozitës të nenit 6 të LPP-së. Andaj, konsideron se në rastin konkret ka vepruar konform dispozitave ligjore dhe parimeve të etikës që duhet të ndjek një gjyqtar me rastin e trajtimit të lëndës, duke qenë se veprimet e marra nga ana e gjyqtarit, janë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe si të tilla nuk paraqesin veprime me të cilin ka shkelur detyrat e punës dhe ka bërë Shkelje ligjore, në të gjitha vendimet ka qenë objektiv dhe ka vepruar në përputhje me dispozitat e LPP-së.

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar deklaratën nga gjyqtari e çështjes, ka bërë verifikimin e shkresave të lëndës CP.nr. 167/2024 dhe pas vlerësimit dhe analizës së tërësishme të provave të mbledhura konsideron se:

#### **Ankesa është e pabazuar.**

Autoriteti kompetent - Kryetarja pas verifikimit të gjithë dokumentacionit ka vërtetuar gjendjen faktike si vijon:

Në Gjykatën Themelore në Prizren — Departamenti i Përgjithshëm është në punë lënda përmbartimore sipas propozimit për përmbartim të kreditorit A.S., nga fshati Pllanjane, Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson av.R.B., nga Prizreni, kundër debitorës së përmbartimit A.P., nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson av.A.M., nga Prizreni, për përmbartimin e dokumentit përmbartimor — aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.902/2021 të datës 02.06.2022, me Objekt të përmbartimit kontakti me fëmijë. Në këtë çështje propozimi për përmbartim në gjykatë është dorëzuar me datë 04.04.2024 e Cila vërtetohet edhe nga vula e pranimit të gjykatës dhe nga numri në sistemin SMIL 2024: 103972.

Me të pranuar lëndën gjyqtari i çështjes S.G., me datë 04.04.2024 me aktvendim ka lejuar përmbartimin e propozuar. Këtë aktvendim pala debitorë A.P., e ka pranuar me datë 23.04.2024 e cila vërtetohet nga fletëdërgesa për dorëzim personal. Pas kësaj gjyqtari gjykues me datë 10.05.2024 ka caktuar seancën dëgjimore në këtë çështje përmbartimore ku kanë prezantuar të gjitha palët ndërgjyqëse dhe përkthyesi gjyqësor i gjykatës. Gjykata në këtë seancë

gjkata ka marrë këtë aktvendim me të cilin ka obliguar që debitorja A.P., , që në afatin prej 7 dite të zbatoj aktvendimin për lejimin e përmbarimit CP.nr. 167/24 të cit. 04.04.2024, sipas dokumentit të përmbarimit aktgjykimit C.nr.902/21, të dt. 02.06.2022, i plotfuqishëm me dt. 29.12.2022 dhe i ekzekutueshëm për përmbarim 18.02.2023, për shkak të kontaktit me fëmijë dhe atë çdo dy javë ditën e premte pas dite nga ora 17, e deri në ditën e shtunë pasdite deri në ora 18, fëmija te qëndroj tek këtu kreditori, si dhe gjatë pushimeve verore dhe dimërore nga 10, ditë tëmija të qëndrojë tej kreditori, ne të kundërtën mos zbatimi i këtij vendimi do të pasoj me shqiptimit të gjobave sipas nenit 15 të LPP-së. Ndërsa gjykata jashtë seancës do të vendos lidhur me parashtrësën e të autorizuarës së debitores e konsideruar si prapsim kundër aktvendimit për lejimin e përmbarimit CP.nr.167/24 të cit. 04.04.2024. Gjkata shkresat e lendes do t'ia dërgon debitores të përkthyer në gjuhën e saj e cila e kupton, vetëm propozimin për përmbarim. Si dhe e autorizuar e debitores nuk ka kërkuar përkthimin e këtij procesverbali pasi që ka pasur përkthyes gjatë kësaj seance. Gjkata propozimin për përmbarim të përkthyer në gjuhën që e kupton pala, ia ka dorëzuar të autorizuarës av. A.M., nga Prizreni, ku e njëjta e ka pranuar me datën 13.05.2024.

Gjkata në këtë çështje me aktvendimin CP.nr,167/24 të datës 29.05.2024 ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitores së përmbarimit, A.P., nga Prizreni të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren CP.nr.167/24 të datës 04.04.2024 duke e lënë në fuqi të njëjtin aktvendim për përmbarim. Këtë aktvendim i cili po ashtu është përkthyer, përfaqësuesja e debitores av.A.M., e ka pranuar me datë 10.06.2024 ndërsa vet pala debitore A.P., me datë 14.06.2024. Ndaj këtij aktvendimi përfaqësuesja e debitores, av.A.M., me datë 14.06.2024 ka parashtruar ankesë drejtuar Gjykatës së Apelit. Në këtë drejtim gjykata ka vepruar menjëherë duke e dërguar një kopje të ankesës për përgjigje palës kreditore A.S., , i cili nëpërmjet përfaqësuesit av.R.B., , me datë 28.06.2024 ka parashtruar përgjigjen në ankesë.

Nga të lartë cekurat është konstatuar se pas dorëzimit të Propozimit për përmbarim procedura nga ana e gjyqtarit ka pasur rrjedhën e përcaktuar me ligj . Sa i përket vërejtjeve të palës ankuese se lënda nuk ka qenë e regjistruar kjo nuk qëndron sepse lënda në momentin e dorëzimit në zyrën e pranimit rregjistrohet në sistem dhe merr numrin , më pas përcillet tek referenti përkatës i lëmisë i cili e regjistron në referatin e caktuar , në rastin konkret në referatin përmbarimor. Kjo përgjegjësi i takon referentit dhe jo e gjyqtarit , gjyqtari e pranon lëndën dhe vazhdon me procedurën e mëtejme . Nuk është detyrë e gjyqtarit të regjistron lëndën , kjo sipas rregullores është detyrë e administratës së gjykatës , referentit i cili e pranon propozimin nga zyra e pranimit dhe e formon lëndën të cilën e përcjellë tek gjyqtarit.

Sa i përket faktit se aktvendimi për lejim të përmbarimit nuk është përkthyer , është rregull se Vula për lejim të përmbarimit është në tre gjuhë zyrtare të cilat përdoren në gjykatën tonë. Gjithsesi gjyqtari nuk ka pasur mundësi që të din se debitorja në rastin konkret nuk e njeh gjuhën në të cilën zhvillohet procedura dhe se është e nacionalitetit boshnjak pasi që Propozimi për Përmbarimin është dorëzuar në gjuhën shqipe, Aktgjykimi i dorëzuar me propozim është në gjuhën shqipe dhe në asnjë prej këtyre shkresave nuk qëndron ndonjë informatë se pala ka pasur përkthyes dhe se shqyrtimi në procedurën kontestimore është mbajtur me përkthyes gjyqësor. Kur gjyqtari ka kuptuar se pala është e nacionalitetit boshnjak atëherë të gjitha shkresat dhe vet seanca është mbajtur me përkthyes.

Andaj bazuar në të lartë cekura si Autoriteti Kompetent — Kryetarja e Gjykatës ka vendosur në dispozitiv të aktvendimit në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 lidhur me nenin 17 paragrafi 5 të Ligjit nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**AD-GJTHPZ.nr.7/2024 me datë 24.07.2024**



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e paraparë e drejta e ankesës.